



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMIT

Adresa; Rr.Ing Gjovalin Gjadri,L.Skenderbeg Shkoder,Tel 022248831,128.

Nr._____ Prot

Shkodër, më 16.01.2024

Lënda: Kthim përgjigje

„Kërkese për Informacion ,nga _____

-Përgjigje e Pyetjeve të kërkuara:

1-Sa zjarrfikës ka aktualisht struktura e MZSH Shkodër: ?

Përgjigje: Aktualisht sot kemi 39-punonjës Zjarrfikës.

2-Sa mjete Zjarrfikëse ka në dispozicion Bashkia Shkodër:?

Përgjigje:7-mjete zjarrfikësë,1-bot mjet,1-Auto shkallë,në gjendje punë,por me amortizim pothuaj total

(sipas tabelës bashkangjitur).

3-Ju lutem na vendosni në dispozicion një inventar të mjeteve që struktura e zjarrfikëve zotërojnë për luftën kundër zjarrit?

Përgjigje:Vo,cdo mjetë zjarrfikës është i kompletuar me mjetet e domosdoshme për çdo ndërhyrje,si zjarre dhe fatkeqesi tjera(sidomos mjetet që në gjuhën teknike janë nisja e parë dhe dyte).(mjetet janë si xhenerator tensioni,saltatrice,gurë prerës hekuri,sharë,si dhe sharë hidraulike,etj)

4- A ka zhvilluar tendera Bashkia Shkodër për përmirësimin e infrastrukturës kundër zjarreve gjatë viteve të fundit?

Përgjigje:Përgjigja e kësaj pyetje është me poshtë pasi e përfshin dhe pyetjen në fjale.

5-A ka zhvilluar Bashkia Shkodër tendera gjatë 5-viteve të fundit për paisje të ndryshme për reparimet zjarrfikëse të cilat janë nën juridiksionin tuaj?.

Përgjigje:Në vitin 2018 ,janë blerë Uniforme Intervenimi (anti-zjarre) ,konkretisht me 13.07.2018 me nje vlere 4,998,000 lekë.Blerje uniforma dt,09.01.2018 vlere 1,196,100 leke.Cizme anti-zjarr 09.01.2018 vlere 604,000 leke.Blerje aparate-frymemarrje (AP3) dt,05.03.2018 leke1,190,400.Blerje mjete ndihmese (aksesor) dt,15.02.2018 leke,604,800.Blerje uniforma dt,19.02.2018 vlere:646,100.leke.Blerje uniforme te zakonshme dt.18.10.2022 vlere 1,104,000 leke.blerje uniforme niveli i mesem 2023 ,vlere 100,000 Leke.

6-A ka patur donacione drejt reparteve zjarrfikëse në Bashkinë Shkodër?

Përgjigje:Kemi patur donacione ne mjete: Automjet Zjarrfikese VOLVO ,ne vitin 2018 ,nga nje shoqate skoceze, dhurate(paguar vetem shpenzimet e transportit nga Bashkia).Ne vitin 2022 kemi dhurate 3-mjete Zjarrfikese nga Qeveria Italiane ,FIAT IVECO me kapacitet 8000Litra . FIAT IVECO me kapacitet 4000 litra. FIAT IVECO me kapacitet 2000litra.Gjithashtu kemi patur nje dhurate nga nje shoqate Belge nje mjet zjarrfikese Denis RAPIER me kapacitet uji 2000 litra ne vlere Hyrje 202,210 leke.

7-A kanë zjarrfikësit e terrrenit veshjet e specializuara zjarrdruuese dhe maskat mbrojtëse për t'u futur në zonë që ka marrë flakë?.Kur është bërë sinovimi i fundit i këtyre mjeteve?.

Përgjigje:Te gjithë punonjesit zjarrfikëse jane te paisur me veshje anti-zjarre si dhe maska mbrojtëse dhe aparate frymemarrje,dhe jane ne gjendje te mire pune.

8-A janë të mjaftueshme këto mjete dhe burimet njerëzore për t'ju përgjigjur situatave emergjente në bashkinë e Shkodrës?.

Përgjigje: Për momentin po.Por ne qofte se duam nje efikasitet me te larte ne nderhyrje,duhet te krijohen reparte te tjera ne Shkoder,ne menyre qe te jemi sa me afer ngjarjeve te ndryshme per nderhyrje si zjarre,apo fatkeqsi te tjera .Eshte bere nje plan nga Bashkia qe te krijohet edhe nje repart i dyle nderhyrje ne Shkoder.

Bashkangjitur Tabelat përkatëse.

D R E J T O R I

Agim Ponari